



Pranuar / Dorezuar Punëtor/Prodator Received/Delivered	07-06-2021	viti god year	1
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Nr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/2021	2915/2021		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.295/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 23.04.2021 me numër A.nr.295/2021, nga ankuesi me adresë: lagjia Dardania rruga "Bulevardi i Dëshmorëve", hyrja 3 kati 3 Komuna e Prishtinës, kundër Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.295/2021 e datës 23.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pozitë "Zyrtar i lartë Ekzekutiv", në Departamentin e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, me Akte emërim të datës 18.11.2016, i caktuar zëvendësues në pozitë "Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit", në kuadër të Departamentit Ligjor, me Vendimin nr.9907 të datës 11.12.2020, i cili me date 04.02.2021 përmes E-mailit zyrtar ka dërguar kërkesë tek Udhëheqësja e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, mbikëqyrëse e drejtpërdrejte të nëpunësit civil :

për të marrë masa disiplinore ndaj tij, lidhur me kërcënimin-sulmin dhe ofendimet e shprehura me datë 04.02.2021, ku rreth orë 8:00 pranë derës së hyrjes të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka ndodhur rasti ndaj ankuesit. Për të cilin rast mbikëqyrësja e drejtpërdrejte e nëpunësit civil z ka marrë veprimet administrative dhe e ka njoftuar ankuesin me datë 05.02.2021 lidhur me

veprimet e saja. Me datë 15.02.2021 përmes E-mailit zyrtar të njësisë së personelit , ankuesi është njoftuar se lënda e tij, është proceduar në Komisionin disiplinor, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm.

Komisioni Disiplinor me date 15.02.2021 ka pranuar E-mailin zyrtar nga U.D. Udhëheqëses së Divizionit të Personelit, në të cilën Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka kërkuar vlerësimin e kompetencës sipas kërkesës së datë 04.02.2021 të iniciuar nga _____ për marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësit civil z.Mirdit Emini.

Me datë 11.03.2021 Komisioni Disiplinor ka nxjerrë Njoftimin me numër protokollit 04/2017, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me kompetencën se për shqyrtimin e këtij rasti paraprakisht duhet të ketë kërkesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të nëpunësit civil, me qenë se nuk ka kërkesë të tillë, Komisioni Disiplinor konsideron se nuk është plotësuar kushti i paraparë sipas dispozitës ligjore të nenit 48 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publikë, për fillimin e procedurës disiplinore.

Ankuesi për mes E-mailit zyrtar të datës 19.04.2021 e ka papranuar Njoftimin me numër protokollit 04/2017 të Komisionit disiplinor të datës 11.03.2021, dhe kundër mos nxjerrjes së Vendimit nga ana e Komisionit Disiplinor, ankuesi me datës 23.04.2021 me numër protokollit 1959/2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore që ti aprovohet ankesa e tij, të nxjerrët vendimi nga komisioni disiplinor sipas kërkesës së E-mailit të datës 15.02.2021, dhe të sigurohen provat materiale lidhur me rastin, duke përfshirë dëshminë e kamerave, dëshmitë e dëshmitarëve dhe nëpunësit :

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.04.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Më datë 28.04.2021 Ministria ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë prej 1/108 faqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesa A.nr.295/2021 me numër protokollit 1959/2021 të datës 23.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi nr.2017 i datës 11.03.2021 nga Komisioni Disiplinor; E-mail Njoftues nga _____ i datës 08.02.2021; E-mail-Njoftues nga zyra e personelit i datës 19.04.2021; E-mail Njoftues nga _____ i datës 05.02.2021; E-mail Njoftues i datës 04.02.2021; E-mail i datës 04.02.2021-kërkesë për marrje të masave disiplinore nga ankuesi _____ E-mail i datës 15.02.2021, -informatë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm; E-mail i datës 04.02.2021 nga znj _____ për sigurim të provave drejtuar ankuesit; E-mail i datës 08.02.2021-njoftim nga _____ për ankuesin; Përgjigje në ankesë e datës 28.04.2021 me nr. protokollit 2053/21; Akt emërimi i datës 18.11.2016; Përshkrimi detyrave të punës; Kërkesë e datës 22.11.2018 për ndryshim plotësim të Akt emërimit nr.10982; Vendimin nr.9907 të datës 11.12.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm; Libri i ekspedic. në vend; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 31.12.2019; Formulari për



vlerësimin e rezultateve në punë; E-mail i datës 12.02.2021 nga për : E-mail zyrtar i datës 04.02.2021 nga znj drejtuar që të deklarohej për rastin; E-mail zyrtar i datës 05.02.2021 nga z. -Deklarat; E-mail zyrtar i datës 04.02.2021 nga drejtuar z. që të deklarohej për rastin; E-mail zyrtar i datës 05.02.2021 nga z. Deklarat; Gjendja aktuale e hyrjes e datës 04.02.2021 për Gjendja aktuale e hyrjes e datës 04.02.2021 për E-mail i datës 27.04.2021 nga aktuale e hyrjes e datës 04.02.2021 për E-maili datës 27.04.2021 nga znj Njoftim për ankuesin; E-mail nga ankuesi tek znj me datë 26.04.2021, lidhur me veprimet administrative për rastin; Përgjigje nga znj ne datë 26.04.2021, E-mail i datës 19.04.2021 nga znj për ankuesin lidhur me njoftimin e komisionit disiplinor, sipas kërkesës së ankuesit në E-mailin e datë 19.04.2021; E-mail i datës 15.04.2021 nga ankuesi drejtuar znj lidhur me rastin e drejtuar komisionit disiplinor nga Sekretari i Përgjithshëm; E-mail njoftues i datës 15.02.2021 për ankuesin lidhur me rastin nga znj E-mail i datës 05.02.2021 njoftim nga znj për ankuesin; E-mail i datës 19.04.2021 nga ankuesi drejtuar znj E-mail i datës 13.04.2021, nga ankuesi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, lidhur për rastin; E-mail zyrtar i datës 13.04.2021 nga znj drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm; E-mail i datës 12.04.2021, nga ankuesi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm; Njoftim i datës 18.01.2021 nr.368 nga znj për Sekretarin e Përgjithshëm; Përgjigje në njoftimin nr.04.10133 të datës 21.12.2020, nga ankuesi; Njoftim i datës 21.12.2020; shkresë nga klinika "Uzllova" në Tiran, Skema mjekimi i datës 15.08.2020, Raport oftamologu i datës 27.07.2020; Skema mjekimi para dhe pas operacionit i datës 18.12.2020; Raport mjekësor Oftalmologji i datës 27.07.2020; Raport mjekësor Oftalmologji i datës 28.07.2020; Raport mjekësor Oftalmologji i datës 08.10.2020; Raport mjekësor Oftalmologji i datës 07.12.2020, me fatura page, me raport refraktive 1/3 faqe; Raport i mjekut specialist i datës 04.06.2020 prej ¼ faqe; Raport i mjekut specialist i datës 23.07.2020 prej ¼ faqe; Raport i mjekut specialist i datës 28.09.2020 prej 1/9 faqe; lista e udhëzimit mjekësor i datës 02.10.2020, listë mjekësore e datës 03.10.2020; Raport mjekësor i specialistit i datës 09.12.2020; Vendim i datës 04.03.2021; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore e datës 05.03.2021; Vendim i datës 04.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me nxjerrjen e Vendimit nga Komisioni Disiplinor sipas E-mailit të datës 15.02.2021 me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i dërguar përmes Udhëheqëses së personelit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe të sigurohet provat materiale lidhur me rastin, duke përfshirë dëshminë e kamerave, dëshmitë e dëshmitarëve dhe nëpunësit z

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komisioni Disiplinor të nxjerrë vendim, lidhur me kërkesën e dërguar përmes formës elektronike E-mailit me datë 15.02.2021 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur

me këtë pretendim Kolegji ka konstatuar se, duke u bazuar në provat e lëndës lidhur me mos nxjerrjen e vendimit sipas kërkesës E-mailit të datës 15.02.2021, ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij ligjore, siç e përcakton neni 48 paragrafin 4 nën paragrafi 4.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil", i cili me datë 11.03.2021 ka nxjerrë Njoftimin me nr. protokolli 04/2017, me të cilin ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm se nuk mund të fillojë procedurën disiplinore lidhur me faktin se procedura disiplinore fillon atëherë nëse është filluar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, që në rastin konkret Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nuk është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil z ndaj të cilit është inicuar rasti respektivisht procedura disiplinore, sipas ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil është "Udhëheqësja e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme", e cila në bazë të provave të lëndës ka analizuar kërkesën e ankuesit të cilin e ka njoftuar me E-mail zyrtar ankuesin me datë 05.02.2021, se do të vepron në bazë të kompetencës ligjore në fuqi, në bazë të kompetencës së saj dhe në pajtim me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", po ashtu e njofton se dispozitat e kodit penal të cekura në kërkesën e datë 04.02.2021, janë kompetencë e organeve të hetueses prokurorisë dhe i rekomandon ankuesin, që rastin ta inicoj tek organi kompetent.

Mbi këtë bazë, Mbikëqyrësja e drejtpërdrejte e nëpunësit civil z. dhe z. pasi ka ndërmarr veprimet administrative dhe ka marrë deklaratat e nëpunësve civil veç e veç, të cilët janë deklaruar përmes E-mailit zyrtar, si në vijim: leklaroj: " dje para orës 08:00 në shesh e kam takuar dhe duke i liruuar njëri tjetrit rrugën atëherë u ndeshëm duke mos u kuptuar dhe kemi shkëmbyer disa fjalë siq janë" pse po më nxen rrugën, shiko nga po hec", dhe në atë moment kamë parë që është ofruar por sharje dhe kërcënime nuk ka pasur", po ashtu dhe z. deklaroi: "unë në cilësi të dëshmitarit jap këtë deklaratë: lidhur me rastin që ka ndodh me datën 04.02.2021 në mes të dhe unë isha duke ardhë në punë, jashtë ndërtesës së ministrisë në shesh takova këta të dy i pash që ishin kanë afër njëri tjetrit dhe unë ndërhyra në mes tyre dhe këta dy vazhduan secili rrugën e tyre dhe diçka tjetër nuk kam vërejtur, kjo është deklarata ime, tjetër nuk kamë çka deklaroj". Si dhe insistimeve të vazhdueshme të ankuesit që të ndërmerr veprime lidhur me rastin pasi ka pranuar njoftimin e datës 11.03.2021 të Komisionit Disiplinor, znj. në cilësi të Mbikëqyrëses së drejtpërdrejte, e ka njoftuar ankuesin përmes E-mailit zyrtar të datës 27.02.2021, se kërkesa e tij dhe deklaratat e nëpunësve civil, kanë mos përputhje të fakteve të paraqitura, e cila e njofton ankuesin, citojë E-mailin zyrtar të datës 27.02.2021:..... në kërkesën e datës 04.02.2021 në ora 13:54 ju keni dërguar E-mail njoftues, se rreth orës 8:00 isha duke hyrë në hyrjen e Ministrisë së Infrastrukturës pranë derës së hyrjes së Ministrisë, në ofendoi dhe më kërcënoi dhe më shajti, i cili ishte me bashkë,a.Sipas SMVP (sistemit për menaxhimin e vijueshmërisë në punë) zyrtari ka regjistruar hyrjen në punë në ora 07:07, kurse në ora 07:54 dhe në ora 07:53, në shkresë nuk keni cekë



saktësisht ofendimin të cilin ua ka bërë z. kurse shkresa e juaj në vazhdim është marrë me çështje ligjore të cilat kanë qenë të gabuara(jeni thirrur në legjislacionin i cili nuk është në fuqi).....3.në mbështetje të fakteve të prezantuara dalja e juaj të cilën e keni sqaruar, jep përshtypje se me qëllim e keni provokuar z. ..4.Pasi që nuk kam gjetur fakte të mjaftueshme, me e-mail i jam drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, ku e kamë njoftuar për rastin në fjalë dhe më tutje nuk është në kompetencën time.....Kurse sa i përket incizimit shumë mirë je i njoftuar se Ministria nuk i menaxhon kamerat e objektit, këtë e përmendi për faktin se ju keni qenë Udhëheqës i zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe keni ushtruar 10 ditë pozitën.... po ashtu për incizimet e kamerave ju kam udhëzuar që të ju drejtoheni organeve kompetente. Ngurrimi i juaj që të ju drejtoheni organeve kompetente më ka vërë edhe më dyshuese në objektivitetin e rastit", që në rastin konkret Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e z dhe z. ka vepruar në bazë të kompetencës lidhur me njoftimin e ankuesit, për rastin e paraqitur me datë 04.02.2021, e cila ka vepruar në pajtim me nenin 7 paragrafin 3 të Rregullores (QRK)NR.11/2020 për Disiplinë dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: 3. Nëse njoftimi i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore, duke e arsyetuar me shkrim mos fillimin e procedurës dhe për këtë e njofton paraqitësin e shkeljes së pretenduar përmes njoftimit formal sikurse që përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës veç e veç të ankuesit dhe organit të punësimit ka konstatuar se Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e dhe me rastin e mos inicimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil, duke e arsyetuar me shkrim mos inicimin duke konstatuar se nuk ka ndonjë elementë që mund të merret për bazë për tu inicuar procedura disiplinore, ka vepruar në pajtim me parimet e individualizimit të masave disiplinore të bazuar në nenin 50 paragrafin 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.4 dhe paragrafin 2 dhe paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se:"1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë;1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji

Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: " Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj", i cili ligj nga data 09.07.2020 është në fuqi sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitat tjera që janë në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, dhe me dispozitat transitorë të nenin 83 për dispozitat transitorë, të këtij ligji, ku përcakton se: "1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.295/2021, datë 07.06.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse


Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
dhe,

Arkivit të KPMSHCK- së.